



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Drejtoria e Hetim Inspektimit

Nr. 6/4/2 Prot

Tiranë, më 20/03/2012

**Lënda :** Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit "TREAL" SH.A.,  
Tiranë.

**VENDIM**

Nr. 04, datë 20/03/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të "TREAL" SH.A., Tiranë ;

**KONSTATOVA**

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësini për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji, dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm, parashikohet: "*Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.*"

Nga verifikimi i regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se, deri më datë 15.03.2012, ende nuk keni plotësuar formularin e njoftimit, sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

-Moszbatimi i nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "d", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që kenë marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, neneve 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

#### V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, “TREAL” SH.A., Tiranë, me gjobë lekë 10 000 (dhjetëmijë) lekë.
2. Gjoha, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi.
3. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 19.03.2012.

Komisioneri

Flora Çabej(Pogaçe)

